

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të dorëzuar nga shoqëria Kin end Karta Group Limited me seli në Spitfajr Blding, rruga 71 Kolier, Londër, H1 9BE, Mbretëria e Bashkuar, e dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatit Georgievski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 27.04.2022, solli

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Kin end Karta Group Limited me seli në Spitfajr Blding, rruga 71 Kolier, Londër, H1 9BE, Mbretëria e Bashkuar do të fitoj kontroll të pavarur mbi Melon SHA me seli në 20 Kosta Lulçev, kati 3, 1113 Sofje, Bullgari, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 24.03.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Kin end Karta Group Limited me seli të regjistruar në Spitfar Blding, 71 Kolier, Londër, N1 9BE, Mbretëria e Bashkuar, me anë të së cilës Kin end Karta Group Limited do të fitoj kontroll të pavarur mbi Melon SHA me seli në 20 Kosta Lulçev, kati 3, 1113 Sofje, Bullgari nëpërmjet shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

-Kin & Karta është një shoqëri në pronësi të plotë të Grupit K + C, një kompani konsulente globale për transformim digjital e kotuar në Bursën e Londrës, e cila angazhohet për të punuar së bashku me klientët për të krijuar një botë më të mirë për të gjithë. K + C është me seli në Londër dhe ka shoqëri të varura në tre kontinente. Strategët, inxhinierët dhe krijuesit e Grupit K + C në mbarë botën bashkojnë fuqinë lidhëse të teknologjisë, informacionit dhe përvojës së kompanive më me ndikim në botë - duke i ndihmuar që të përshpejtojnë zhvillimin e tyre digjital, të prezantojnë masa novatore, të modernizojnë sistemet e tyre, të përmirësojnë ekipet e tyre, dhe të ketë optimizim për rritje të vazhdueshme. K + C është fokusuar në ofrimin e rezultateve për klientët përmes inovacionit, modernizimit dhe optimizimit, duke përfshirë ndihmën e menaxherëve për të kuptuar më mirë ndryshimet e tregut dhe se si produktet dhe shërbimet duhet të zhvillohen, duke përdorur teknologji të reja për të krijuar produkte dhe platforma të reja. , duke rritur investimet dhe përvojat digjitale përmes teknologjisë moderne të marketingut dhe platformave të të dhënave. K + C është kompania e parë e kotuar në bursën e Londrës, e cila zotëron një certifikatë të korporatës-B. I Përbush standardet më të larta të performancës së provuar sociale dhe ekologjike, transparencës publike dhe përgjegjësisë për të balancuar lidhjen e trefishtë midis njerëzve, planetit dhe fitimit.

Kin end Karta ofron shërbime konsulente të transformimit digjital, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: zhvillimin e uebit, dizajnin e softuerit, këshillimin e ciklit jetësor të produktit, e-mësimin, zhvillimin e softuerit, dizajnin UX/UI, inteligjencën e biznesit, inteligjencën artificiale, rritjen e inteligjencës, të dhënat e mëdha, analiza e biznesit, integrimi i të dhëna, inxhinieri e të dhënave, shkenca e të dhënave, vizualizimi i të dhënave me inteligjencë artificiale, zhvillimi i softuerit dhe operacionet e informacionit, integrimi në renë kompjuterike, menaxhimi i API, interneti, konsulenca strategjike, kontrolli i cilësisë, logjika e biznesit.

Grupi K + C nuk është aktiv në Maqedoninë e Veriut.

-Melon SHA është një partnere e certifikuar e ISO-së, e Microsoft Gold, e cila shërben klientët me renome. Mellon dhe shoqëritë e saj të varura punësojnë 300 specialistë të teknologjisë dhe të dhënave për Bullgarinë, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën. Mellon AD ofron shërbime për zhvillimin e plotë të produkteve teknologjike, konsulencë teknologjike, mirëmbajtje dhe mbështetje, si dhe shërbime testimi për klientët që punojnë në telekomunikacion, farmaci, argëtim, prodhim ushqimi, teknologji financiare, prodhim, marketing digjital etj. Mellon AD punon me Agjencitë digjitale dhe softuerike, ndërmarrjet dhe kompanitë start-up në projekte të mëdha dhe të vogla. Punonjësit e Mellon janë të përfshirë në projekte që mundësojnë zhvillimin e produktit nga faza fillestare deri në atë përfundimtare, duke përfshirë korrigjimin e mangësive në fazat kritike përfundimtare të projekteve. Mellon AD zhvillon marrëdhënie afatgjata me klientët duke ofruar shërbime për mirëmbajtje dhe mbështetje. Mellon ka një ekip të përkushtuar për sigurimin e cilësisë për projektet e zhvillimit të aplikacioneve. Ekipi është i përfshirë gjithashtu në analizën logjike të biznesit, testimin funksional, analizën e përdorimit, vlerësimin heuristik, kompatibilitetin dhe aftësinë e shfletuesit dhe automatizimin e ndërfaqes. Mellon AD renditet në vendin e parë në Bullgari dhe në vendin e 23 në botë sipas Clutch nga 1000 kompanitë më të mira B2B në mbarë botën.

Melon AD është aktive në Maqedoninë e Veriut përmes Mellon -Technologies SHPKNJP Shkup me seli në rr. 1737 Nr.32, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me aktivitet të regjistruar - programim kompjuterik dhe është shoqëri që është në pronësinë e saj të plotë.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски